



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për pjesëmarrjen e stafit të Teatrit të Qytetit “Bekim Fehmiu” nga Prizreni, në Festivalin Mbarëkombëtar të Komedisë “Koko Fest” që do të mbahet nga data 04 shtator 2025 deri me 06 shtator 2025, në qytetin e Korçës të Republikës së Shqipërisë. Kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet për pagesë të mëditjeve për stafin pjesëmarrës.
2. Teatri i Qytetit “Bekim Fehmiu” nga Prizreni, në këtë Festival do të marrin pjesë me shfaqjen teatrore: “Komedia e zezë”.
3. Pjesë e kësaj shfaqjeje nga stafi i teatrit do të jenë: Xhevdet Doda-aktor, Alban Krasniqi-aktor, Hajat Toqilla-aktore, Valmira Hoti-aktore, Liridona Shehu Bytyqi-aktore, Zana Duraku-asistente e regjisë, Alban Çela- aktor, Alban Morina- aktor, Mahir Musliu-inspicient, Krenar Gaxholli-financier, Vjollca Hoxhaj-gardorobiere, Arben Rashkaj-rekuiziter, Flamur Krasniqi-tonist, Fikrim Menekshe-ndriçues, Murat Javori-dekorater, Shqipe Gallapeni-teknike e skenës, Fatos Berisha-udhëheqës artistik, Burim Mustafa-drejtor i Teatrit.
4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime.
5. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Teatri i Qytetit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurve,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

